

**VENDIM**  
**Nr. 11, datë 23.1.2023**

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ERA HYDRO” SHPK PËR MARRJEN E  
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN E ASETVE TË HEC “STORI”  
NË FAVOR TË BANKËS AMERIKANE TË INVESTIMEVE SHA**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “a”, dhe nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, germa “g”, neneve 6, 7 dhe 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.1.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 66/1 prot., datë 19.1.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Era Hydro’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve të HEC ‘Stori’ në favor të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Era Hydro” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 66 prot., datë 10.1.2023, prot., ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin e aseteve të HEC “Stori” në favor të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., me qëllim garantimin e shlyerjes së kredisë.

- Shoqëria “Era Hydro” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Stori”, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 62, datë 8.4.2020, dhe është mbajtëse e licencës nr. 462, seria P20.

- Marrëveshja e Barrës Siguruese nr. 2962 rep., nr. 1288 kol., datë 7.6.2019 me Bankën Amerikane të Investimeve sh.a. (në cilësinë e barrëmarrësit) është nënshkruar përpara se shoqëria të licencohet nga ERE në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike (datë 8.4.2020).

- Për sa më sipër, ERE nuk mund të marrë në shqyrtim këtë kërkesë, për sa kohë marrëdhënia juridike me bankën për vendosje barre siguruese është krijuar përpara se shoqëria të merrte statusin e të licencuarit dhe të lindnin detyrimet përkatëse në kuadër të këtij statusi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Era Hydro” sh.p.k. për transferimin e aseteve të HEC “Stori” në favor të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**